

# GLOBALIZIMI

Mr. Rejhan Neziri

## A. Përkufizimi

Në fillim duhet të bëjmë dallimin midis termave globalizëm (globalism) dhe globalizim, globalizacion (globalization). Globalizmi, në thelbin e tij, përshkruan dhe shënon jo më tepër se një botë e cila karakterizohet me rrjete të lidhjeve që i kapërcejnë hapësirat multi-kontinentale. Përkundër kësaj, globalizimi shënon rritjen ose zvogëlimin në shkallë të globalizmit. Ai fokusohet në forcat, dinamizmin ose shpejtësinë e këtyre ndryshimeve. Globalizmi, pra, e përshkruan realitetin e të qenët i ndërlidhur, kurse globalizimi përfshinë shpejtësinë në të cilën këto lidhje shtohen apo pakësohen.<sup>1</sup> Në këtu do të merremi me konceptin ‘globalizim’\*, edhe pse për të njëjtën dukuri shpesh e hasim edhe termin globalizëm, sidomos e hasim të përdoret si një rrymë apo tendencë e cila e mbështet fort procesin e globalizimit.

Ç’është e vërteta, ekzistojnë shumë përkufizime (definicione) për atë se ç’është në të vërtetë globalizimi dhe lirisht mund të thuhet se këto përkufizime në të shumtën e rasteve janë tepër subjektive dhe varen nga përvoja dhe pozita e përkufizuesit, në ai ka mendime e qëndrime pro ose anti-globaliste.

Një definicion tipik – mirëpo kufizues – mund të merret nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN ose IMF), i cili e thekson ndërvarësinë ekonomike gjithnjë në rritje të vendeve rreth e përqark botës përmes shtimit të vëllimit dhe shumëllojshmërisë së transaksioneve tej-kufitare në mallra e në shërbime, rrjedhjen e lirë ndërkombëtare të kapitalit si dhe shpërndarjen tejte të shpejtë e të gjerë të teknologjisë.<sup>2</sup>

Ky definicion ka të bëjë më shumë me të ashtuquajturin globalizim ekonomik, ndërsa shumë të tjerë duken se pajtohen me atë se globalizimi më shumë është një koncept qytetërimi (civilizimi) me aspektet e ndryshme të tij ekonomike, politike, kulturore dhe teknologjike, të cilët mund të jenë ngushtë të gërshetuar me njëri-tjetrin.

Duke u mbështetur me sa u tha më lart, mund të themi se “Globalizimi është një term përfaqësues për një seri komplekse të ndryshimeve ekonomike, sociale, teknologjike, kulturore dhe politike, që vërehen në ndërvarësinë (interdependence), integrimin dhe ndërveprimin (interaction) gjithnjë në rritje midis popujve dhe kompanive në vende të ndryshme të globit, botës”.<sup>3</sup>

Ata që globalizimin e vlerësojnë si një zhvillim pozitiv, parimet bazë të tij i përmbledhin nën këta tituj: shekullarizimi, demokracia liberale, ekonomia e tregut të lirë dhe shteti juridik kushtetutar. Disa të tjerë këtë e shprehin më shkurtë me treshin e termave: në fushën e së drejtës, revolucioni

<sup>1</sup> Joseph Nye, „Globalism Versus Globalization“, në: [www.theglobalist.com](http://www.theglobalist.com) .

\* Për këtë dukuri në gjuhën frënge përdoret termi „Mondialisation“, kurse në atë arabe „el-Awlemeh“ (العولمة).

<sup>2</sup> IMF Staff, “Globalization: Threat or Opportunity?”, 2000, në: [www.imf.org](http://www.imf.org) .

<sup>3</sup> <http://en.wikipedia.org/wiki/Globalization>

“i të drejtave njerëzore”; në fushën e politikës, demokracia liberale dhe në fushën e ekonomisë, ekonomia e tregut të lirë dhe prodhimi i mbështetur në konkurrencë.<sup>4</sup>

## B. Historiku i globalizimit

Si një term “globalizimi” ka filluar të përdoret qysh në vitin 1944, mirëpo ekonomistët kanë filluar ta aplikojnë aty kah viti 1981. Termi “fshat global” u afirmua pas botimit të veprës *Understanding Media* (Routledge, Londër, 1964) nga autori M. McLuhan. Ndërkaq Theodore Levitt është meritor i farkimit të termit ‘globalizim’ përmes një artikulli të tij që ai e shkroi në vitin 1983 për Harvard Business Review të titulluar “Globalization of Markets” (“Globalizimi i tregjeve”).<sup>5</sup>

Meqë kjo fjalë ka dy kuptime, edhe teknike edhe politike, është e qartë se grupe të ndryshme do të kenë edhe histori të ndryshme të “globalizimit”.

Në trajtimin e historisë së globalizimit, disa autorë fokusohen në ngjarjet që nga 1492, mirëpo shumica e dijetarëve e teoricienëve përqendrohen në një të kaluar shumë më të afërt. Ndërkaq shumë më parë se viti 1492, njerëzit kanë filluar t’i lidhin bashkë vendet e ndryshme të globit në sisteme të gjera të komunikimit, migrimit e të ndërlydhjes. Ky formim i sistemeve të ndërveprimit midis globales dhe lokales ka qenë një forcë motivuese kryesore në historinë botërore.\* Të këtyra kanë qenë rastet si: përhapja dhe shtrirja e religjioneve botërore, hinduizmi, budizmi, xhainizmi, sihizmi, taoizmi, konfuçionizmi, jehudizmi, krishterimi, islami etj. ; “rruga e mëndafshtë” (silk road), ekspansioni i Xhengis Kanit, Aleksandrit të Madh; krijimi i perandorive të mëdha botërore; zbulimi i kontinenteve tjera të botës; përhapja e tregtisë me skllëvër; revolucioni amerikan e francez; kolonizimi; luftërat botërore; dekolonizimi etj.<sup>6</sup>

“Epoka e parë e globalizimit” ka filluar me periudhën e standardit të arit\*\* dhe të liberalizimit\*\*\* në shek. XIX. E mbështetur në Pax Britannica dhe në këmbimin e mallrave, kjo epokë është zhvilluar bashkë me industrializimin. Kjo epokë thuhet se dobësohet në fazat e fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe përfundon me krizën e standardit të arit në vitet e vona 1920 dhe në fillim të viteve 1930. Vendet që në këtë epokë u angazhuan në globalizim, përfshirë bërthamën e Evropës, disa periferi si dhe disa degëzime të Evropës në Amerikë e në Oqeani, prosperuan dukshëm. Pabarazia midis këtyre vendeve u zhduk si pasojë e rrjedhjes së lirë të mallrave, kapitalit e punës midis këtyre popujve.

Që nga Lufta e Dytë Botërore e këndeje globalizimi është lëvizur nga raundet e negociatave mbi tregtinë, fillimisht nën patronazhin e GATT-it\*\*\*\*, që kanë çuar në një seri të marrëveshjeve për ngritjen e kufizimeve në tregtinë e lirë. Raundi i Uruguait (1984-1995) ka çuar te marrëveshja për

<sup>4</sup> Mehmet S. Aydın, “Küreselleşmeye Genel Bir Bakış”, në: grup autorësh, *Siyasi, Ekonomik ve Kültürel Boyutlarıyla Kreselleşme*, Ufuk Kitapları, Stamboll, 2002, f. 13.

<sup>5</sup> Mehmet S. Aydın, po aty, f. 11; <http://en.wikipedia.org>.

\* Për një histori shumë-shumë më të hershme të historisë së sistemit botëror shih sidomos punimin e Andre G. Frank dhe Barry K. Gills, *The Five Thousand Year World System: An Interdisciplinary Introduction*, në: [www.rojadsatabank.org](http://www.rojadsatabank.org).

<sup>6</sup> Shih: “A Quick Guide to the World History of Globalization”, në: [www.sas.upenn.edu/~dludden/global1.htm](http://www.sas.upenn.edu/~dludden/global1.htm)

\*\* „Standardi i arit“ është një sistem monetar në të cilin njësia ekonomike standarde për llogari është një peshë e fiksuar e arit, <http://en.wikipedia.org>.

\*\*\* „Liberalizimi“ shënon para së gjithash një lirim dhe zbutje të kufizimeve të mëhershme qeveritare, zakonisht në fushën e politikës sociale apo ekonomike. <http://en.wikipedia.org>.

\*\*\*\* GATT (The General Agreement on Tariffs and Trade – Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë [e Jashtme]) në fillim është themeluar nga The Bretton Woods Conference si pjesë e një plani më të madh për restaurimin ekonomik pas Luftës II Botërore. GATT-i ka përfshirë një reduktim në tarifatat dhe në pengesat tjera ndërkombëtare dhe përgjithësisht konsiderohet si paraardhës i The World Trade Organization (Organizatës Botërore të Tregtisë), shih, <http://en.wikipedia.org>.

themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT ose WTO), për të ndërmjetësuar në mosmarrëveshjet tregtare. Me qëllim të reduktimit të tarifave e të pengesave tregtare janë nënshkruar edhe një sërë marrëveshjesh dy e më shumëpalëshe, përfshirë këtu edhe Marrëveshjen e Mastrihtit (Maastricht Treaty) në Evropë dhe Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Amerikën Veriore (The North American Free Trade Agreement - NAFTA\*<sup>7</sup>).

### C. Natyra dhe ekzistenca e globalizimit

Ekzistojnë diskutime të shumta akademike rreth asaj nëse globalizimi është një fenomen i vërtetë apo vetëm një artefakt (mit) analitik. Edhe pse termi në fjalë është mjaft i përhapur, shumë autorë thonë se karakteristikat që i vishen globalizimit sot janë vërejtur edhe më herët në kohë të ndryshme të historisë. Pra, shumë ka që thonë se këto tipare, përfshirë edhe rritjen në tregtinë ndërkombëtare si dhe rolin gjithnjë më të madh të korporatave multinacionale, nuk janë ngulitur aq thellë sa mund të duket se janë.

Disa autorë më me ëndje e parapëlqejnë termin internacionalizim sesa globalizim. Te internacionalizimi, roli i shteteve dhe rëndësia e kombeve janë më të mëdha, ngase globalizimi në formën e tij complete i eliminon shtetet kombëtare. Kështu ata thonë se kufijtë e shteteve, në kuptimin më të gjerë, janë larg ngritjes së tyre totale prandaj edhe ky proces i globalizimit nuk ndodh dhe me siguri edhe nuk do të ndodhë, duke marrë parasysh se në historinë botërore internacionalizimi kurrë nuk është shndërruar në globalizim (Bashkimi Evropian dhe NAFTA akoma janë duke e provuar rastin e tyre).

Megjithëkëtë, bota gjithnjë e më shumë po i ndanë problemet dhe sfidat që nuk u binden kufijve të shteteve kombëtare, në veçanti ndotja e mjedisit natyror si dhe lëvizja që publikisht njihet si anti-globalizim, e cila është transformuar në një lëvizje për globalizim nga poshtë, duke kërkuar, përmes eksperimentimit, forma të organizimit shoqëror që i tejkalojnë kufijtë e shteteve kombëtare dhe demokracinë përfaqësuese.

Disa autorë të tjerë thonë se jemi duke kaluar në një fazë planetare të qytetërimit; forma dhe karakteri i saktë i shoqërisë globale po kontestohet dhe kjo do të përcaktohet nga zgjedhjet që do t'i bëjmë në dekadat e ardhshme kritike. Për shembull, The Global Scenario Group (Grupi i Skenarit Global)\*\* ka skicuar mendime alternative për të ardhmen globale, me ç'rast "forcat e tregut" ose globalizimi ekonomik janë vetëm njëri opsion, i vënë përballë "reformës në politikë", "botës kala", "shkatërrimit", "eko-komunalizmit" dhe një "paradigme të re vazhdimësie".<sup>8</sup>

Disa të tjerë janë të mendimit se globalizimi është një gjeografi e imagjinuar; d.m.th. një mjet politik i qeverisjes së neoliberalistëve, të cilët tentojnë t'i përdorin disa pamje e diskurse të politikës botërore për t'i arsyetuar agjendat e tyre politike.

\* NAFTA - The North American Free Trade Agreement (Marrëveshja për Tregti të Lirë e Amerikës Veriore) është themeluar në janar të vitit 1994 nga Kanadaja, SHBA-ja dhe Meksika dhe përbën rajonin më të madh në botë të tregtisë së lirë <http://www.nafta-sec-alena.org> .

<sup>7</sup> <http://en.wikipedia.org> .

\*\* The Global Scenario Group është themeluar në vitin 1995 nga The Stockholm Environment Institute për të angazhuar një grup të dalluar e të ndryshëm ndërkombëtar në një shqyrtim të prospekteve për zhvillimin botëror në shekullin 21. Shih më gjerësisht: [www.gsg.org](http://www.gsg.org) .

<sup>8</sup> Shih web faqen Global Issues That Affect Everyone: [www.globalissues.org](http://www.globalissues.org) .

## Ç. Karakteristikat e globalizimit

Globalizimi / internacionalizimi është identifikuar me një numër prirjesh, shumica prej të cilave kanë mund të zhvillohen që nga Lufta II Botërore. Këto përfshijnë një lëvizje më të madhe ndërkombëtare të të mirave, të parave, të informatave e të njerëzve, si dhe përfshijnë zhvillimin e teknologjisë, organizatave, të sistemeve juridike e të infrastrukturës që e lejojnë dhe mundësojnë një lëvizje të këtyre.

Në vazhdim do të përmendim veçoritë kryesore të këtij procesi të manifestuar në jetën ekonomike, kulturore, juridike e teknologjike.

### 1. Në nivelin *ekonomik* globalizimi shfaqet në:

- rritjen e tregtisë ndërkombëtare në një shkallë shumë më të shpejtë sesa rritja e ekonomisë botërore,
- shtimin e rrjedhjes ndërkombëtare të kapitalit përfshirë edhe investimet e jashtme direkte,
- lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë shkaktuar krijimin e organizatave si WTO\* (Organizata Botërore e Tregtisë) dhe të karteleve ekonomike siç është OPEC,\*\*
- zhvillimin e sistemeve globale financiare,
- rritjen e rolit të organizatave ndërkombëtare siç janë WTO, WIPO\*\*\*, IMF\*\*\*\* që merren me transaksione ndërkombëtare,
- shtimin e praktikave ekonomike si outsourcing (përdorimi i burimeve të jashtme) dhe offshoring (zhvendosje e proceseve të biznesit nga një vend në tjetrin) nga korporatat multinacionale...

### 2. Në nivelin *kulturor* globalizimi shfaqet në:

- shkëmbimin kulturor gjithnjë më të madh ndërkombëtar,
- përhapjen e multikulturalizmit si dhe pranimin më të mirë individual në shumëllojshmërinë kulturore, për shembull përmes eksportimit të filmave të Hollywoodit e të Bollywoodit. Megjithatë, kultura e importuar lehtë mund t'ia zërë vendin kulturës lokale duke shkaktuar me këtë rast reduktimin e shumëllojshmërisë

\* WTO - The World Trade Organization është organizata e vetme globale internacionale e cila merret me rregullat e tregtisë midis kombeve. Është themeluar në Gjenevë të Zvicrës më 1 janar 1995. Më gjerësisht shih: [www.wto.org](http://www.wto.org).

\*\* OPEC - The Organization of the Petroleum Exporting Countries (Organizata e Vendeve Transportuese të Naftës) është një organizatë e përhershme, ndërqeveritare e themeluar në Konferencën e Bagdadit 10-14 shtator 1960, nga ana e Iranit, Irakut, Kuvajtit, Arabisë Saudite dhe Venezuelës. Më vonë këtyre pesë anëtarëve nismëtarë u bashkëngjiten edhe tetë të tjerë: Katari (1961); Indonezia (1962); Libia (1962); Emiratet e Bashkuara Arabe (1967); Algjeria (1969); Nigeria (1971); Ekuadori (1973–1992) dhe Gaboni (1975–1994). OPEC-u zyrtar qendrorë të tij në pesë vitet e para të themelimit i ka pasur në Gjenevë, Zvicër, kurse që nga 1 shtatori 1965 e këndej i ka në Vjenë të Austrisë. Shih, [www.opec.org](http://www.opec.org).

\*\*\* WIPO - The World Intellectual Property Organization (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) është një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara. Ajo i dedikohet zhvillimit të një sistemi të balancuar e të pranueshëm të pronësisë intelektuale ndërkombëtare, e cila e shpërblen krijimtarinë, e stimulon zbulimin e risive dhe e mbështet zhvillimin ekonomik duke e ruajtur interesin publik. WIPO është themeluar nga Konventa WIPO në vitin 1967 me një mandat nga shtetet anëtare për ta promovuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale në barë botën përmes bashkëpunimit midis shteteve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Zyrtar e kësaj agjencie gjenden në Gjenevë të Zvicrës. Shih më gjerë, [www.wipo.int](http://www.wipo.int).

\*\*\*\* IMF - The International Monetary Fund (Fondi Monetar Ndërkombëtar) është themeluar në vitin 1945 për t'i ndihmuar shëndetit të ekonomisë botërore. Me zyrtar e tij në Uashington DC, ai udhëhiqet dhe mban përgjegjësi përpara 184 vendeve të cilat e përbëjnë anëtarësinë e tij pothuaj globale. Më gjerë shih, [www.imf.org](http://www.imf.org).

- përmes hibridizimit ose madje edhe përmes asimilimit. Forma më e spikatur e kësaj është westernizimi (perëndimizimi), mirëpo gjithashtu ndodh edhe sinicizimi ose sinifikimi (asimilimi gjuhësor apo kulturor i termave dhe koncepteve në gjuhën apo kulturën kineze),
- udhëtimin dhe turizmin gjithnjë më të madh ndërkombëtar,
  - imigrimin më të madh, përfshirë edhe imigrimin ilegal,
  - shtrirjen e prodhimeve të gatshme lokale (p.sh. ushqimit) në vende të tjera (shpesh të adaptuara ndaj kulturës së atyre vendeve),
  - modat (trillet) botërore dhe në kulturat pop(ullore) siç janë Pokemon, Sudoku, Numa Numa, Origami, Seritë idole, YouTube, My Space, Messenger dhe shumë të tjera.
  - ngjarjet botërore të sportit siç është Kupa Botërore e FIFA-s (Federata Ndërkombëtare e Futbollit) dhe lojërat olimpike,
  - formimin ose zhvillimin e një sërë vlerash universale...

### 3. Në nivelin *teknik / juridik* globalizimi manifestohet në:

- zhvillimin e një infrastrukture globale për telekomunikim dhe në rrjedhjen më të madhe të të dhënave përtej kufirit, duke përdorë teknologjinë si internetin, satelitët për komunikim, fijet optike të nëndetëseve dhe telefonat celularë,
- shtimin e numrit të standardeve të zbatuara në shkallë globale, p.sh. ligjet për të drejtat e autorit (copyright laws) dhe patentat,
- iniciativën e shumë avokatëve për themelimin e gjykatave ndërkombëtare për krime lufte dhe lëvizjeve ndërkombëtare për drejtësi, si për shembull kemi ICC - The International Criminal Court (Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Lufte) dhe ICJ – The International Court of Justice (Gjykata Ndërkombëtare)...<sup>9</sup>

Shpesh thuhet se madje edhe terrorizmi ka pësuar një globalizim, me sulmet në vendet e jashtme që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me vendin amë.<sup>10</sup> Mendime e sidomos deklarata të këtilla sot dëgjohen nga shumë politikanë anekënd botës, “lufta kundër terrorizmit global” etj...

## D. Pro-globalizimi (Globalizmi)

Mbështetësit e ‘globalizimit demokratik’ herë-herë quhen edhe pro-globalistë. Ata konsiderojnë se faza e parë e globalizimit, e cila ka qenë me orientim tregtar, duhet të kompletohet nga një fazë e ngritjes së institucioneve globale politike që do ta përfaqësojnë vullnetin e ‘qytetarëve botërorë’. Dallimi prej globalistëve të tjerë është se këta nuk përcaktojnë paraprakisht ndonjë ideologji që do ta drejtonte këtë vullnet, çka i lihet zgjedhjes së lirë të këtyre qytetarëve përmes një procesi demokratik.

Mbështetësit e tregtisë së lirë theksojnë se teoritë ekonomike të ‘përfitimit komparativ’ sugjerojnë që tregtia e lirë çon në një akordim efektiv të burimeve, me çka të gjitha vendet e involvuara në

<sup>9</sup> <http://en.wikipedia.org> .

<sup>10</sup> Shih Keith Porter, „The Future of Terrorism“, në: <http://globalization.about.com> dhe Asta Maskaliunaite, “Terrorism and Globalization: Recent Debates”, në: <http://venus.ci.uw.edu.pl> .

këtë tregti do të përfitojnë. Marrë në përgjithësi, kjo shpie te çmimet më të ulëta, punësimin më të madh dhe rendimentet më të larta.

Vullnetaristët dhe ithtarët e tjerë të kapitalizmit *laissez-faire* thonë se shkallët më të larta të lirisë politike dhe ekonomike në formë të demokracisë dhe kapitalizmit në botën e zhvilluar janë dy caqe në vetvete dhe po ashtu krijojnë nivele më të larta të kamjes materiale. Këta globalizimin e shohin si një përhapje dhe shtrirje të dobishme të lirisë dhe kapitalizmit.

Kritikët thonë se lëvizja anti-globaliste përdor dëshmi anekdotike për t'i mbështetur pikëpamjet e saj dhe se statistikat gjithëbotërore në të vërtetë e mbështesin fort globalizimin:

- Përqindja e njerëzve që në vendet në zhvillim jetojnë me të ardhura nën 1 \$ amerikanë në ditë është përgjysmuar brenda vetëm njëzet viteve<sup>11</sup>, edhe pse disa kritikë janë të mendimit se duhen studiuar më mirë e më thellë ndryshoret për matjen e varfërisë.<sup>12</sup>
- Jetëgjatësia thuhet se është dyfishuar në vendet në zhvillim që nga Lufta II Botërore dhe ka filluar ta mbyllë hendekun me vendet e zhvilluara ku përmirësimi ka qenë më i vogël. Vdekshmëria e fëmijëve ka rënë në çdo rajon të botës në zhvillim.<sup>13</sup> Pabarazia e të ardhurave për botën si tërësi po zvogëlohet.<sup>14</sup>
- Demokracia është shtuar në mënyrë dramatike nga pothuajse asnjë komb me të drejtë universale të votës në vitin 1900 deri te 62.5 % të të gjitha kombet në vitin 2000.<sup>15</sup>
- Mes viteve 1950 – 1999, shkrim e leximi është shtuar nga 52 % në 81 % të botës. Femrat e përbënin hendekun më të madh: shkrim-leximi i femrave si një përqindje e shkrim-leximit të meshkujve është rritur nga 59% në vitin 1970 në 80% në vitin 2000.
- Përqindja e fëmijëve si forcë punëtore ka rënë nga 24% në vitin 1960 në 10% në vitin 2000.
- Tendenca të njëjta vërehen edhe në fushën e energjisë elektrike, veturave, radio-televizioneve, telefonave etj. për kokë banori, si dhe përqindja e atyre që furnizohen me ujë të pijshëm.<sup>16</sup>

Megjithëkëtë, disa nga këto përmirësime mund të mos jenë pasojë e globalizimit, ose mund të jenë të mundshme edhe pa formën aktuale të globalizimit.

Disa pro-kapitalistë janë po ashtu kritikë ndaj Bankës Botërore dhe FMN-së, duke thënë se këto dy institucione janë burokraci të korruptuara që kontrollohen dhe financohen nga ana e shteteve e jo nga ana e korporatave. Shumë hua u janë dhënë diktatorëve të cilët asnjëherë nuk i kanë realizuar reformat e premtuara dhe të cilët ia kanë lënë popullit të thjeshtë që t'i paguajë ato më vonë.

Disa të tjerë, si senatori Douglas Roche, globalizimin e shohin thjeshtë si një gjë të pashmangshme dhe e përkrahin krijimin e institucioneve si të një Asambleje Parlamentare të Kombeve të Bashkuara të zgjedhur drejtpërdrejtë, për të ushtruar mbikëqyrjen mbi institucionet e pazgjedhura ndërkombëtare.<sup>17</sup>

<sup>11</sup> Shih më gjerësisht, <http://iresearch.worldbank.org> .

<sup>12</sup> Shih p.sh. Michel Chossudovsky, “Global Falsehoods: How the World Bank and the UNDP Distort the Figures on Global Poverty”, në: [www.transnational.org](http://www.transnational.org) .

<sup>13</sup> Guy Pfefferman, “The Eight Losers of Globalization”, në: [www.theglobalist.com](http://www.theglobalist.com) .

<sup>14</sup> David Brooks, „Good News about Poverty“, në: [www.columbia.edu](http://www.columbia.edu) .

<sup>15</sup> Shih Freedom House, [www.freedomhouse.org](http://www.freedomhouse.org) .

<sup>16</sup> Charles Kenny, “Why Are We Worried About Income?”, në: [www.sciencedirect.com](http://www.sciencedirect.com) .

<sup>17</sup> <http://en.wikipedia.org> .



## DH. Anti-Globalizimi (Drejtësia Globale)

Kritikët e aspekteve ekonomike të globalizimit e kontestojnë atë se globalizimi është, ashtu siç dëshirojnë ithtarët e tij ta kuptojnë, një proces i papërkulur që rrjedh natyrshëm nga nevojat ekonomike të secilit. Kritikët në mënyrë tipike theksojnë se globalizimi është një proces që diktohet nga imperativet e elitës, dhe në mënyrë tipike e diskutojnë mundësinë e institucioneve dhe politikave alternative globale, të cilat, besojnë ata, do ta adresojnë kërkesën morale të klasave të varfra e punëtorë anekënd globit si dhe shqetësimet për mjedisin në një mënyrë shumë më të drejtë.<sup>18</sup>

Sa i përket çështjes së diskutueshme mbi migrimin global, diskutimet rrotullohen rreth dy pikave: rreth shkaqeve, në çfarë mase migrimi global është vullnetar apo jovullnetar, i domosdoshëm apo jo i domosdoshëm, dhe rreth pasojave, nëse është kjo e dobishme, apo ka ndonjë çmim shoqëror dhe ambiental. Ithtarët e globalizimit priren ta shikojnë migrimin thjeshtë si një proces me ç'rast punëtorët jakëbardhë dhe jakëblu mund të shkojnë nga një vend në tjetrin për t'i kryer shërbimet e tyre, ndërkaq kritikët priren t'i theksojnë rastet negative si pasiguria ekonomike, politike dhe ambientale, dhe si një efekt të dukshëm negativ e citojnë lidhshmërinë midis migracionit dhe rritjes enorme të lagjeve të varfra (varosheve) në vendet në zhvillim.<sup>19</sup>

Aspekte të ndryshme të globalizimit shihen si të dëmshme nga aktivistët të interesit publik si dhe nga nacionalistët e fuqishëm të shtetit. Kjo lëvizje nuk ka një emër të përbashkët. Termi “anti-globalizim” është një term që më shumë e preferojnë mediet: Kjo mund të çojë në disa ngatërime, sepse aktivistët i kundërshtojnë vetëm disa aspekte apo forma të globalizimit, e jo vetë globalizimin. Vetë aktivistët, për shembull Noam Chomsky, kanë thënë se ky emër është i pakuptimtë, ngase qëllimi i kësaj lëvizjeje është globalizimi i drejtësisë (shtrirja e drejtësisë sociale në mbarë globin). Në fakt, ‘lëvizja për drejtësi globale’ është një emër i përbashkët. Shumë aktivistë ndërkaq bashkohen nën sloganin “një botë tjetër është e mundur”.

Ka një sërë llojesh të anti-globalizimit. Në përgjithësi, kritikët thonë se rezultatet e globalizimit nuk janë ato që janë predikuar kur kanë filluar përpjekjet për shtimin e tregtisë së lirë, dhe se shumë institucione të involvuara në sistemin e globalizimit nuk i kanë marrë në konsideratë interesat e popujve të varfër, klasën punëtorë si dhe ambientin.

Argumentet ekonomike të teoricienëve të tregtisë së ndershme thonë se tregtia e lirë e pakufizuar u shkon në interes atyre me forcë financiare (pra të pasurve) në dëm të të varfërve.

Shumë të tjerë e shohin globalizimin si një promovim të agjendës korporatiste, e cila ka për synim ndrydhjen dhe shkurtimin e lirive individuale në emër të fitimit. Ata po ashtu pohojnë se shtimi i autonomisë dhe fuqizimi i entiteteve korporative në mënyrë të shkallëshkallshme e formëson politikën e shteteve-kombe.

Disa grupe anti-globaliste pohojnë se globalizimi pashmangshëm ka një karakter imperialistik, është njëra prej arsyeve shtytëse të luftës në Irak dhe i detyron kursimet që të rrjedhin drejt SHBA-ve e jo drejt vendeve në zhvillim e sipër; mund të thuhet se globalizimi në këtë kuptim është një term tjetër për një formë të ‘amerikanizimit’, saqë nga disa vrojtues besohet se SHBA-të mund të jenë njëri nga shumë shtete (nëse jo edhe i vetmi) që vërtet përfitojnë nga globalizimi.

Disa pohojnë se globalizimi e imponon ekonominë e mbështetur në borxhe, çka rezulton me rritjen e paparashikueshme të borxheve e të krizave të borxheve.

Kriza financiare në Azinë Juglindore që filloi në vitin 1997 në ekonominë relativisht të vogël, të ngritur me borxhe të Tajlandës por që shumë shpejt u përhap në Malajzi, Indonezi, Korenë e

<sup>18</sup> [www.forumsocialmundial.org.br](http://www.forumsocialmundial.org.br).

<sup>19</sup> UN-HABITAT, “Cities and Globalization: A Race to the Bottom?”, në: [www.unhabitat.org](http://www.unhabitat.org).

Jugut dhe eventualisht në një rrip të gjerë botëror, i shfaqti rreziqet e reja dhe paqëndrueshmërinë në tregjet e globalizuara që ndryshojnë në mënyrë rapide\*. Paratë 'shpëtimtare' të FMN-së kanë ardhur me kushtëzime për ndryshime politike në vend dhe kjo nga kritikët është parë si një minim i sovranitetit nacional sipas modës *neo-kolonialiste*.

Shumë institucione globale që kanë ndikim të madh ndërkombëtar as që udhëhiqen në mënyrë demokratike e as që liderët e tyre janë zgjedhur në mënyrë demokratike. Prandaj, sipas disave ata konsiderohen si forca mbikombëtare jodemokratike.

Kundërshtimi kryesor i bëhet globalizimit të *papenguar* (neoliberal; kapitalizmit *laissez-faire*), që udhëhiqet nga qeveritë dhe nga ato që supozohet të jenë kuazi-qeveri (si FMN-ja dhe Banka Botërore\*\*) dhe të cilat me sa duket nuk merren në përgjegjësi nga popullatat që ato i qeverisin dhe që në vend të kësaj ata kryesisht u përgjigjen interesave të korporatave. Shumë konferenca të mbajtura nga ministrat e tregtisë dhe të financave të vendeve që e përbëjnë thelbin e kombeve të globalizimit zhvillohen nën protesta të mëdha, herë-herë të dhunshme, nga kundërshtarët e "globalizimit të korporatave".

Disa aktivistë të anti-globalizimit e kundërshtojnë faktin se "globalizimi" aktual i globalizon paratë dhe korporatat, e jo edhe njerëzit dhe sindikatat. Kjo mund të vërehet në kontrollin e rreptë të imigrimit në pothuajse të gjitha shtetet, si dhe nga mungesa e të drejtave të punëtorëve në shumë vende të botës në zhvillim e sipër.

Një kamp tjetër akoma më konservativ që e kundërshtojnë globalizimin janë nacionalistët shtet-centrikë të cilët kanë frikë se mos globalizimi po e zëvendëson rolin e kombeve në politikën globale dhe organizatat joqeveritare po i plason si forca që i tejkalojnë kufijtë e kombeve të caktuara individuale.

Kjo lëvizje është shumë e gjerë, duke përfshirë grupet kishtarë, fraksionet nacional liberale, partitë majtiste, ambientalistët, sindikalistët e fshatarëve, grupet anti-raciste, anarkistët, përkrahësit e rilokalizimit etj. Shumica prej këtyre janë reformistë (që e përkrahin një formë më humane të kapitalizmit), ndërkaq të tjerët janë më tepër revolucionarë (që pretendojnë se atë që ata e besojnë është një sistem shumë më human sesa kapitalizmi). Shumë e kanë qortuar mungesën e bashkimit dhe drejtimit brenda lëvizjes, mirëpo disa si Noam Chomsky kanë deklaruar se kjo mungesë e centralizimit në fakt mund të jetë një forcë.

Protestat e lëvizjes për drejtësi globale i kanë detyruar takimet e larta (samitet) ndërkombëtare të mbahen larg qyteteve të mëdha ku mbaheshin zakonisht, në lokacione të vetmuara ku protestat janë të pamundshme.

## Matja e globalizimit

Se në çfarë mase është globalizuar një shtet-komb apo një kulturë brenda një vitit të caktuar deri vonë kohëve të fundit është matur përmes përfaqësuesve të thjeshtë si rrjedhja e tregtisë, migrimi ose investimi i drejtpërdrejtë nga jashtë. Një qasje shumë më e sofistikuar për matjen e globalizimit është indeksi bashkëkohor i kalkuluar nga instituti zviceran për hulumtime (think

\* Më tepër rreth kësaj krize shih: Mahatir Muhamed, *Një marrëveshje e re për Azinë*, BFI-FSHI, Shkup, 2004.

\*\* Banka Botërore - The World Bank – është një burim vital për ndihmë financiare dhe teknike për vendet në zhvillim anekënd botës. Ajo nuk është një bankë në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Më zanafillën në vitin 1944 dhe me selinë e saj në Washington DC, ajo është e përbërë nga dy institucione unike për zhvillim e pranuar nga 184 vende të botës: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (The International Bank for Reconstruction and Development-IBRD) dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (International Development Association - IDA). Më gjerësisht shih: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org).



tank) KOF<sup>\*</sup>. Indeksi në fjalë i mat tri dimensionet kryesore të globalizimit, atë: ekonomik, social dhe politik. Krahas tre treguesve për matjen e këtyre dimensioneve, kalkulohet edhe një indeks i përgjithshëm i globalizimit dhe nën-tregues që u referohen rrjedhave aktuale ekonomike, kufizimeve ekonomike, të dhënave për kontakt personal, të dhënave rreth rrjedhave informative si dhe të dhënave rreth lidhjeve kulturore. Të dhënat jepen në bazë vjetore për 122 vende. Sipas këtij indeksi, vendi më i globalizuar në botë është SHBA-ja, e pasuar nga Suedia, Kanada, Mbretëria e Bashkuar dhe Luksemburgu. Vendet më pak të globalizuara sipas indeksit të KOF-it janë Togoja, Çadi dhe Republika e Afrikës Qendrore.<sup>20</sup>

---

\* KOF Konjunkturforschungsstelle: [www.kof.ch/globalization](http://www.kof.ch/globalization) .

<sup>20</sup> <http://en.wikipedia.org> .